



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:269467
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05611755

C-IV-14-4552

Parashtruesi i kërkesës

I G, nga Kaçaniku

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NSH - PMN “Sharr” në likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 24 prill 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. Vërtetohet Vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI042-4445 datë 8 maj 2014.**
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 12 qershor 2014, ankuesi parashtroj pranë DHPGJS një kërkesë, të emërtuar ankesë, për rishqyrtimin e Vendimit GJI042-4445 datë 8 maj 2014 (tani e tutje Vendimi), lëshuar nga ana e Autoritetit të Likuidimit të AKP (tani e tutje: AL), me të cilin vendim ankuesit i është refuzuar kërkesa me të cilën, sipas Vendimit, është kërkuar kompensimi për paga të papaguara, për periudhën nga viti 1993 e gjer me 1999, në shumë prej 6,939.00 (gjashtë nëntë tre nëntë) Euro, ndaj NSH PMN “Sharr” në likuidim.

Ankuesi me kërkesën për rishikim – ankesë pretendon të drejtën në akcione.

Ankuesi kundërshtoj Vendimin e AL e cila i mohoj të drejtën e tij e cila paraqet një shumë simbolike. Ankuesi kundërshtoj formën e privatizimit të NSH si dhe kundërshtoj kërkesën drejtuar atij nga ana e AL, për dokumentacion shtesë. Sipas ankuesit është e pamundur të plotësohet një kërkesë e tillë dhe se gjithë dokumentacioni i kërkuar gjendet pranë organit të administratës së NSH.

Ankuesi pohon se NSH, me Vendimin e Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë, FI878/91 datë 12 qershor 1991, është transformuar në Shoqëri Aksionare (SHA) e që edhe përkundër këtij

fakti çimentorja dhe njësitë tjera janë privatizuar, që nga data 13 qershor 2000 e gjer në vitin 2010. Kjo formë e privatizimit, sipas ankuesit, konsiderohet jo-ligjore, pasi që nuk janë respektuar procedurat e tenderimit si dhe në procedurë të privatizimit nuk janë respektuar të drejtat e punëtorëve në pjesëmarrjen e 33% të aksioneve.

Nga gjitha arsyet, ankuesi, kërkon që kërkesa e tij të aprovohet si e bazuar.

Kërkesës për rishikim i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL,

AKP me 6 shkurt 2017 parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj kërkesë për rishikim-ankesën duke e konsideruar si të pabazuar. AKP pohoj se AL me rastin e vendosjes dispozitat ligjore i ka zbatuar në mënyrë të drejtë. AKP gjithashtu konsideron se ankuesi, me ankesën e tij, nuk ka ofruar ndonjë argument ligjor ashtu siç parashihet edhe sipas dispozitave ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP tutje pohoj se ankuesi nuk ka vepruar sipas kërkesës së saj mbi dorëzim e dokumentacionit shtesë e në favor të kërkesës së tij kreditore e në anë tjetër statusi i NSH si ndërmarrje shoqërore është vërtetuar edhe me Vendimin e Bordit të AKP. Nga gjitha arsyet u propozua që kërkesa për rishikim-ankesa të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e kërkesës, së AL, drejtuar ankuesit mbi dokumentacionin shtesë.

Ankuesi me 20 shkurt 2017 parashtroj përgjigje ndaj përgjigjes së AKP.

Ankuesi mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishikim-ankesës dhe e kundërshtoj pohimet e AKP si të pabazuara. Tani ankuesi pohon se kërkesa për paga i takon periudhës kur i është ndërprerë marrëdhënia e punës në mënyrë të dhunshme dhe pa pëlqimin e tij dhe në mënyrë diskriminuese. Ankuesi tutje kundërshtoj pohimet e AKP se kërkesa e tij kreditore është parashkruar për faktin se është inicuar padi pranë Gjykatës Komunale në Ferizaj dhe se sipas gjitha gjasave kjo lëndë është asgjësuar nga organet Serbe e në anën tjetër nuk i posedon shkresat e lëndës për shkak se shtëpia i është djegur.

AKP me 6 mars 2017 parashtroj kundërpërgjigje.

AKP mbeti në tërësi si pranë përgjigjes së saj.

Me Aktvendimin e gjykatës, datë 7 mars 2024, kërkesa për lirim nga pagesa e taksave gjyqësore është refuzuar.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtrirat e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsytimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankuesit që të dëshmoj detyrimet ndaj tij, respektivisht të drejtën në kompensimin e të ardhurave personale, ashtu siç qëndron në kërkesën pranë AL dhe Vendimit të saj si dhe në kërkesën me përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP.

Gjithashtu është obligim i ankuesit që të dëshmoj detyrimet ndaj tij, respektivisht të drejtën në kompensimin në emër të pronësisë së aksioneve, ashtu siç qëndron në kërkesën për rishikim-ankesë.

Ankuesi nuk ka ofruar asnjë argument dhe provë me të cilat do të dëshmohej ndërprerja e marrëdhënies së punës e po ashtu edhe e drejta në kompensimin në paga e që si rezultat do të tërhiqte edhe të drejtën për paga të papaguara, për periudhën e kërkuar të viteve 90’.

Po ashtu, ankuesi nuk ka dëshmuar të drejtën e ti në aksione (dividendë dhe të drejtat tjera pronësore si aksionar), ashtu siç parashihet sipas Ligjit mbi ndërmarrjet me ndryshime dhe plotësime (gazeta zyrtare e RSFJ nr. 77/88, 40/89, 46/90 dhe 61/90); Ligjit mbi kapitalin shoqëror (gazeta zyrtare e RSFJ nr. 84/89 dhe 46/90) dhe Ligjit mbi plotësimet dhe ndryshimet e ligjit mbi kushtet dhe procedurat e transformimit në forma të ndryshme të pronësisë (gazeta zyrtare e R.S. nr. 49/91, 75/91 dhe 51/94), ligje këto të zbatueshme sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 për Ligjin e zbatueshëm në Kosovë.

Për më tepër, ashtu siç qëndron në arsyetimin e Vendimit të AL, ankuesi ishte i obliguar që në procedurën pranë AL të dëshmoj të drejtat e tij në aksionare, ashtu siç qëndron sipas nenit 36 paragrafi 2 pika 2, e Shtojcës së Ligjit për AKP.

Ankuesi gjithashtu, edhe në procedurën e shqyrtimit të ankesës së tij, ashtu siç parashihet sipas dispozitave të cekura si më lartë të Ligjit për DHPGJS, nuk ka parashtruar dëshmi mbështetëse të cilat do ti argumentonin pohimet e tij.

Andaj nga gjitha arsyet gjykata konsideron se ankuesi nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi kompensimin ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6.1, 1.5 dhe 1.8 por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS

Barra e provave bie mbi ankuesin që të dëshmonte të drejtat e tij, sipas dispozitave të lartë cekura ligjore.

Nga të gjitha arsyet, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Obiter dictum (ndër të tjerash)

Edhe pse nuk është pjesë e këtij Aktgjykimi, gjykata gjatës shqyrtimit të kërkesës për rishikim-ankesës gjeti se kjo ankesë nuk ishte e nënshkruar nga ana e ankuesit. Por në rastin konkret për vetë faktin se ankuesi në vijim, me përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP dhe veprimeve tjera

procedurale, mbeti në tërësi si pranë ankesës-kërkesës për rishikim dhe se përgjigjen e kishte nënshkruar, në këtë kuptim gjykata konsideroj se ankuesi plotësoj kushtet e pranueshmërisë së kërkesë/ankesës ashtu siç parashihet sipas nenit 35 të Ligjit për DHPGJS.

Taksa Gjyqësor

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar